

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar
Tiranë, më 18.12.2018

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8328,
DATË 16.4.1998, “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN
E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË TË PARABURGOSURVE”,
TË NDRYSHUAR

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 27 nëntor dhe 18 dhjetor, mori në shqyrtim projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”. Komisioni i Ligjeve caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, znj.Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë, përfaqësues të misionit Euralius, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Avokatit të Popullit.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”, vjen me nismë të Këshillit të Ministrave, dhe është bazuar në nenin 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji shoqërohet nga relacioni, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja e një regjimi të posaçëm të ushtrimit të të drejtave për një kategori të dënuarish dhe të paraburgosurish, me synim kufizimin e të drejtave të të dënuarve që janë pjesë e krimit të organizuar.

Regjimi i posaçëm do të zbatohet për të dënuar për krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, organizatë terroriste apo për vepra me qëllime terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal.

- Standardet ndërkombëtare dhe kombëtare lidhur me trajtimin e të dënuarve

Nisma e propozuar vlerësohet sipas standardeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, ose legjislacioni “i butë” kryesisht rekomandimet e përditësuara të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për standardet e trajtimit në burgje, rekomandimet specifike të Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Rekomandimi (Rec. 2006)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi rregullat Evropiane të Burgjeve”

Pjesa IV “Rregulli në burg” përcakton standardet e trajtimit të personave të privuar nga liria, përfshirë të dënuarit e rrezikshëm ose trajtimi i tyre në rrethana të jashtëzakonshme.

53.1 *Masat e posaçme të sigurimit dhe të sigurisë merren vetëm në raste përjashtimore.*

53.2 *Në rast aplikimi të masave të tilla ka procedura të qarta.*

53.3 *Natyra e këtyre masave, kohëzgjatja dhe kushtet në të cilat zbatohet ato përcaktohen nga legjislacioni kombëtar.*

53.4 *Aplikimi i masave që zbatohen, miratohen nga organi kompetent për një periudhë kohë të caktuar.*

53.5 *Çdo vendim për të shtyrë periudhën e miratuar është subjekt i një miratimi të ri nga organi kompetent.*

53.6 *Masa të tilla aplikohen për individë ose për grupe të burgosurish.*

53.7 *Çdo subjekt për të cilin është zbatuar një masa e tillë ka të drejtën e ankimit.*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 25

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 28

..... 5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

- ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION DHE NDRYSHIMET E MIRATUARA

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision nga relatori, anëtarët e Komisionit dhe të ftuarit në mbledhje u diskutuan disa çështje lidhur me trajtimin e regjimit të posaçëm në projektligj, si dhe adaptimin e normave dhe të praktikave evropiane në sistemin shqiptar të burgjeve.

Konkretisht diskutime pati mbi autoritetin që do të marrë vendimin për vendosjen e të dënuarve dhe të paraburgosurve në regjim të posaçëm, nëse do të jetë gjykata apo Ministri i Drejtësisë. Kjo pasi në projektligj nuk përcaktohet qartë se kush është autoriteti që merr vendimin për vendosjen e të dënuarve nën regjimin e posaçëm. Gjithashtu, nuk përcaktohet momenti se kur fillon zbatimi i regjimit të posaçëm për të dënuarin, në momentin kur fillon kryerjen e dënimit apo në rastin e një situate të jashtëzakonshme.

Gjithashtu, relatori u shpreh se në analizën e nenit 1 të projektligjit është e nevojshme të vlerësohet respektimi i parimit të proporcionalitetit, si dhe kohëzgjatja e regjimit të posaçëm me qëllim që të minimizohen pasojat shumë të dëmshme të kufizimit të lirisë, si dhe të shmangen mundësitë që mund të çojnë në trajtim jo njerëzor të të dënuarve.

Relatori informoi se lidhur me projektligjin është zhvilluar dhe një tryezë diskutimi me përfaqësues të misionit EURALIUS, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Avokatit të Popullit, Bazuar në diskutimet e zhvilluara në këtë tryezë dhe në propozimet e ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe misioni Euralius, u vlerësua se neni 1 i projektligjit ka nevojë për disa rregullime në përmbajtjen e tij.

Në përfundim të diskutimeve në Komision, duke marrë parasysh propozimet e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit, si dhe ndryshimet e miratuara nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare, Komisioni miratoi riformulimin e nenit 1 të projektligjit si më poshtë:

“Neni 1

Pas nenit 13, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998, të ndryshuar, shtohet neni 13/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 13/1

Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë

1. Në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të këtij neni, një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave, mund zbatohet për të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë, dhe të paraburgosurit që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste.

2. Vendimi për vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë merret nga Ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

3. Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, të referuara në pikën 1 të këtij neni, nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen, kryesisht, me nevojën për të parandaluar:

- a) kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;
- b) konfliktet e mundshme me elementë të organizatave të tjera;
- c) ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;
- ç) komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve që i përkasin grupeve të ndryshme.

4. Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave konsiston në:

- a) lejimin e një takimi familjar në muaj, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohet hyrja e personave apo sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Me termin “familjarë” nënkuptohen të paralindurit, të paslindurit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Takimi me persona të ndryshëm nga familjarët, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e Ministrit të Drejtësisë. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës;
- b) lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kurse, për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e

Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;

c) ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që mund të marrë i dënuari ose i paraburgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

ç) kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

d) reduktimin e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;

dh) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve apo të paraburgosurve.

5. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë është një vit. Me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, pas një periudhe një vjeçare, Ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të rivlerësojë nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit.

6. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës mund të paraqesin kërkesë ankimore brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit.

7. Kërkesa ankimore depozitohet në gjykatën e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas parashikimit të nenit 480, të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e Ministrit të Drejtësisë.

8. Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, Ministri i Drejtësisë vendos bazuar në vendimin e gjykatës.”

Në riformulimin që propozohet për nenin 1, janë bërë këto ndryshime në dallim nga formulimi i nenit në variantin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave:

1. Propozohet që regjimi i posaçëm të vendoset vetëm në raste të veçanta, në përputhje me parashikimet e standardeve ndërkombëtare dhe në veçanti me nenin 41 bis të ligjit italian;
2. Në grupin e neneve të veprave penale për të cilat parashikohet vendosja e këtij regjimi, sipas propozimeve të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, propozohet të shtohen disa vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë, që janë nenet 79¹, shkronja “ç”, 79/a², 79/b³ dhe 284, paragrafi i tretë⁴ të Kodit Penal.
3. Propozohet që vendosja e regjimit të posaçëm të bëhet me vendim të Ministrit të Drejtësisë, mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit,

1 Vrasja në rrethana të tjera cilësuese ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse;

2 Vrasja e funksionarëve publikë

3 Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit

4 Organizmi, drejtimi apo financimi i kultivimit të kanabisit

Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

4. Me propozim të Avokatit të Popullit, është bërë shtesa që kufizimi i bisedave telefonike nuk aplikohet në rastet e komunikimeve me institucionin e Avokatit të Popullit;
5. Sipas modelit të nenit 41 bis të ligjit italian propozohet që koha e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, të jetë deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;
6. Gjithashtu propozohet që kërkesa ankimore kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm të bëhet në gjykatën e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

- PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë me ndryshimet e mësipërme, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

ADNOR SHAMETI

KRYETARI

ULSI MANJA